



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:158845

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05518080

P.nr.177/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurit V (P) G, nga fsh. D K. K, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par. 3 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, dhe Xh. L dhe B. L për veprën penale Uzurpim i paluajtshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nr PP//II.nr.1470/2021, të datës 05.08.2022, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt. 28.02.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit V. G, dhe mbrojtësit të tij i caktuar Ex officio, av. Marjan Nrecaj, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 28.02.2024, të njëjtën ditë gjykata shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 28.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

V. G i lindur me dt..... në fsh. D. K. K, nga babai P dhe e ëma P e vajzërisë N, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion furrtar, i cili jeton në Z, i martuar i gjendjes së mesme ekonomike, identifikuar me numër personal....., i cili ka kërkuar që vendimi të dërgohet vëllait të tij, A (P) G nga fsh. D, K.K, nacionaliteti shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I pandehuri V (P) G:

- I. Me datë, rreth orës, në fshatit D. K. K, si pronar, ndërton objekt pa leje për të cilin kërkohet leja e tillë në bazë të ligjit për ndërtim¹ dhe atë nenit 7 dhe 14, në atë mënyrë që, i pandehuri V në njësinë kadastrale P-...., e evidentuar si pronë shoqërore fillon ndërtimin e murrit rrethues dhe vendosjen e 4 (katër) shtyllave të betonit, për të cilën nuk kishte leje nga organet Komunale, ku edhe me datë 01.03.2021, nga Inspektorati Komunal i Ndërtimit i Komunës së Klinës, i janë ndaluar punimet,
- me këtë ka kryer veprë penale *“Ndërtimi pa leje”* nga neni 359 par. 3 lidhur me par. 2 të KPRK-së.
- II. Në kohë të panjohur e në vazhdimësi gjerë me datë, në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën shoqërore të Komunës së Klinës, në atë mënyrë që, i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme, pa asnjë bazë ligjore, në kohë të panjohur uzurpon pronën shoqërore të Komunës së Klinës me nr. P-..... në fshatit D. K. K, në sipërfaqe prej 1.08.33 ha dhe të njëjtën pronë e shfrytëzon si dhe fillon ndërtimin e murrit rrethues dhe vendosjen e 4 (katër) shtyllave te betonit.
- me këtë ka kryer veprë penale *“Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme”* nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 48, 47 dhe 69 dhe 70 dhe nenit 359 par. 3 lidhur me par. 2 dhe nenit 320 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së:

GJYKON
DËNIM ME KUSHT DHE DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit V. G, Gjykata i përcakton sipas dispozitivit -I- dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej një (1) viti, nuk kryen veprë të re penale, ndërsa sipas dispozitivit -II- e dënon me dënim me Gjobë në shumën prej 400 (katërqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi

ME DËNIM UNIK Konform nenit 76 të KPRK-së.

Gjykata e dënon me Dënim Burgu në kohëzgjatje prej një (1) viti, - cili denim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej (1) viti nuk kryen veprë të re penale, dhe

DËNIM ME GJOBË

I. Shuma në vlerë prej (400) katërqind euro, të cilin denim i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotëfuqshmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën e shqiptuat, dënimi me gjobë do të shëndrrohet në dënim me burgim duke e llogaritur 20 (njëzet) Euro për një ditë.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet nëse i pandehuri kryen veprë penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, konform nenit 50 të KPRK-së.

III.OBLIGOHET: I pandehuri që në emer të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, dhe tarifën për kompensim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

IV.Dënim plotësues: Konform nenit 359 par. 5 të KPRK-së, ndërtimi pa leje të rrënohet dhe shpenzimet për këtë i barten kryesit të veprës penale.

III. DETYROHET: I pandehuri që ta liroi pronën në afatin ligjor prej 4 (katër) muaj, në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqshmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjën nr PP/ /II.nr. 1470/2021 të datës 05.08.2022 ndaj të pandehurit V. G nga fsh. D K. K, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par. 3 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par. 1 të KPRK-së,

Gjykata fillimisht ka bërë Veçimin e Procedurës konform nenit 35 të KPPRK-së për të pandehurit Gj. L, dhe B. L, i cili do të merr nr. të ri penal.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt.28.02.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i akuzuari V. G dhe mbrojtësit të tij të caktuar Ex officio av. Marjan Nrecaj.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri pas konsultimit paraprak të mbrojtësit të tij, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej ne barre, me vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaroi se shpreh pendesë për veprën penale të kryer. I pandehuri ka deklaruar se une e kam liruar pronën si dhe kam bërë ndërprerjen e punimeve rreth ndërtimit, ku kam menduar që ta ndërtoj një kafiteri të vogël. Pra une e kam liruar pronën.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Marjan Nrecaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pasi që i pandehuri pranoi fajësinë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të lirë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresë të lënda. I propozoj gjykatës që të pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale që i vihet ne barre, dhe me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethënë lehtësuese.

Po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit av. Marjan Nrecaj ka deklaruar se pandehuri pas konsultimit paraprak me të mbrojturin tim i cili deklaroi se i njëjti pranoi fajësinë dhe shpreh keqardhje por duke u bazuar në rrethana të tjera siç janë i njëjti nuk është i dënuar asnjë herë për penale, punimet që i ka bërë në fushë të sportit në prone publike i ka ndërpre punimet në momentin e daljes në vend të inspektorit të ndërtimitarisë të komunës së Klinës, ku i njëjti deklaroi se prej momentin të daljes në vend i pandehuri V. G nuk ka ndërmarr asnjë veprim në lidhje me ndërtimin se që d.m.th. i ka zbatuar urdhrat e inspektorit. Sa i përket pastrimit të terrenit t ku ka pas filluar ndërtimin i kanë mbetur vetëm ca blloka për të pastruar, sa i përket pikës 2 që ka të bëjë me uzurpim nuk ka pas qellim që të pasurohet pa baze. I njëjti kërkoi që të shqiptoj një dënim me të bute të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që

përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari, ka kryer veprën penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par. 3 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti i ka kryer dy veprat penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjukata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPRK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, dhe pendimin e tij, padënueshmërinë e tij më parë, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i pandehuri i ka ndërpre punimet menjëherë dhe e ka liruar pronën e uzurpuar,. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata gjeti dashjen e kryerjes së veprave penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Të pandehurit Konform nenit 76 të KPRK-së. Gjukata e dënon me Dënim Burgu në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 viti nuk kryen vepër të re penale, dhe dënim me gjobë Shuma në vlerë prej (400) katërqind euro, të cilin dënim I pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotëfuqshmërisë së këtij aktgjykimi. Andaj duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjukata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të

kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimin është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.177/2022 me datë 28.03.2024

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.